



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

Nr. 840 / Prot.

Tiranë, më 2 . 4 .2021

URDHËR

Nr. 09 , Datë 02 . 04 .2021

**“Për
fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese në disa njësi përbërëse të
Universitetit të Tiranës”**

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 36, pikat 2 dhe 7 dhe neni 39; Statutit të UT-së, neni 39, neni 46 dhe neni 50 si dhe të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës”, Kreu I, pika 12:

URDHËROJ:

1. Fillimin e procesit zgjedhor në datën 09 prill 2021, për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese:
 - a) Dekan i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja;
 - b) Përgjegjës i Departamentit të Matematikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës;
 - c) Përgjegjës i Departamentit të Mbrojtjes nga Rrezatimi dhe Rrjetet e Monitorimit në Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar.
2. Zhvillimi i zgjedhjeve për autoritetet drejtuese të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të bëhet në datën 12 maj 2021.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar, të Universitetit të Tiranës.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


REKTORI
Prof. Dr. Artan Hoxha
